

---

**RREGULLORE  
E  
LOJËS PROMOCIONALE 'FITO DUKE PËRDORUR DIGITAL BANKING' ORGANIZUAR NGA  
"INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA.**

Organizimi i lojës promovionale "Fito duke përdorur Digital Banking" bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 155/2015 "Për Lojërat e Fatit në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) si dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 196 datë 15.03.2017 "Për përcaktimin e mënyrave, të formave, kriterëve dhe të rregullave për organizimin e lojërave të fatit promovionale". Kjo lojë promovionale hyn në fuqi me termat dhe kushtet e parashikuara në këtë rregullore, vetëm pasi "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA të jetë pajisur me autorizimin paraprak nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, pranë Ministrisë së Financave.

**NENI 1  
ORGANIZATORI I LOJËS PROMOCIONALE DHE QËLLIMI**

1.1 Subjekti organizues i lojës promovionale është "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA, e krijuar me Vendimin Nr. 19460 datë 19.05.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e regjistruar në QKB me Nr. NIPT J81817006P me seli në adresën: Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, P.O Box 8319, 1001, Tiranë, e përfaqësuar nga administratori Z. Silvio Pedrazzi (këtu e më poshtë referuar si "Banka");

1.2 Kjo lojë zhvillohet sipas autorizimit të lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

1.3 Qëllimi i kësaj loje promovionale është rritja e përdorimit të aplikacionit bankar dixhital të ofruar nga "Intesa Sanpaolo Bank Albania" Sha si dhe edukimi i përdoruesve të këtij aplikacioni mbi mundësitë dhe lehtësitat e përdorimit shërbimit bankar dixhital si mjet për realizimin e pagesave.

**NENI 2  
AFATI**

2.1 Loja promovionale do të zhvillohet për 6 muaj kalendarik Qershor, Korrik, Gusht Shtator Tetor dhe Nentor 2020. Data e fillimit është data 1 Qershor 2020 dhe data e përfundimit të lojës promovionale është 30 Nëntori 2020. Shorteu për përzgjedhjen e fituesit për secilin muaj, do të hidhet në datat që vijojnë 10 Korrik, 10 Gusht, 10 Shtator, 12 Tetor, 10 Nentor dhe 10 Dhjetor ora 10:00.

2.2 Loja Promovionale mund të ndërpritet vetëm në rastin e rrethanave për të cilat Banka nuk është përgjegjëse, dmth., që nuk mund parandalohen, riparohen apo shmangen si dhe në rast të ndonjë urdhërimit sipas ligjeve në fuqi nga autoritetet shtetërore. Njoftimi për ndërprerjen dhe çdo njoftim tjetër i rëndësishëm në lidhje me Lojën e Fatit Promovionale, do të publikohet në <https://www.intesasanpaolobank.al/>.

**NENI 3  
KRITERET DHE KUFIZIMET E PJESËMARRJES**

3.1 Pjesëmarrësit në lojë do të jenë të gjithë subjektet (individë) që plotësojnë kriteret e mëposhtme në mënyrë kumulative përgjatë afatit të lojës promovionale: i) janë Klientë të "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA që kanë nënshkruar me Bankën Kontratën "Për Kryerjen e Veprimeve Bankare ndërmjet Platformës së Shërbimeve Bankare Dixhitale"; ii) janë përdorues të shërbimit të ri bankar dixhital duke përdorur faqen e internetit dhe/ose aplikacionin e shkarkuar në aparatit celular; iii) kryejnë gjatë një muaji kalendarik përmes shërbimit bankar dixhital 5 (pesë) ose më shumë transfertat të suksesshme brenda apo jashtë bankës. Një klient bëhet pjesë e shorteut në muajin përkatës nëse ka përmbushur kriteret më lart.

---

3.2 Punonjësit e "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA nuk do të jenë pjesë e lojës promovionale.

#### **NENI 4**

##### **MEKANIZMI DHE KRITERET E LOJES PROMOCIONALE**

4.1 Promocioni do të organizohet në formën e një loje dhe përzgjedhja e fituesve do të bëhet nga një program kompjuterik. Nëpërmjet këtij programi do të importohet lista e të gjithë klientëve që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 3.1 dhe do të përcaktohet sa fitues duhet të gjenerohen për muajin përkates. Përzgjedhja e fituesve do të gjenerohet në mënyre totalisht rastësore.

4.2 Subjektet që plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes në këtë lojë promovionale nuk do të paguajnë kosto shtesë për pjesëmarrjen në këtë lojë. Klientët do të paguajnë vetëm komisionet dhe tarifat që parashikohen në Kontratën " Për Kryerjen e Veprimeve Bankare ndërmjet Platformës së Shërbimeve Bankare Dixhitale", komisione dhe tarifa të cilat nuk kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në lojën promovionale, por lidhen ngushtësisht me përdorimin e shërbimit bankar dixhital që banka ofron (si psh komision mirëmbajtje, komision për token hardware/rilëshim token në rast dëmtimi/humbje/vjedhje, komisioni i fondit të transferimit, komisioni i overdraftit, komisione të tjera për produkte dhe shërbime që Klienti mund të blejë përmes shërbimit bankar dixhital sipas kushteve të punës së bankës në fuqi).

4.3 Një klient bëhet pjesë e shorteut në muajin përkates nëse ka përmbushur kriteret e pjesëmarrjes të përcaktuara në nenin 3.1 të kësaj rregulloreje. Transfertat e kryera nga Klienti i Bankës në platformën e shërbimit dixhital brenda një muaji kalendarik nuk llogariten për shorteun e muajit pasardhës. Për tu bërë pjesë e shorteut në muajin pasardhës klienti duhet të plotësojë sërish kriteret e përcaktuara në nenin 3.1 të kësaj rregulloreje. Nëse Klienti i Bankës përmbush kriteret si më sipër përcaktuar në më shumë se një apo në të gjithë muajt gjatë së cilit është i vlefshëm promocioni, atëherë do të jetë pjesëmarrës në shorte në secilin nga muajt që kualifikohet.

4.4 Data e kryerjes së transaksioneve në platformën dixhitale bankare duhet të jetë brenda afatit të paracaktuar për zhvillimin e lojës.

4.5 Do të konsiderohen si transaksione të vlefshme vetëm ato veprime që do të jenë autorizuar si të suksesshme në platformën dixhitale bankare.

4.6 Nëse transaksionin i kryer nga Klienti në platformën dixhitale bankare anulohet ose kthehet mbrapsht, transaksioni i anuluar/ kthyer mbrapsht nuk do të konsiderohet si pjesë e shumatores së transaksioneve të vlefshme.

4.7 Nëse shërbimi bankar dixhital mbyllet në mënyrë përfundimtare nga sipas parashikimeve të bera në kontratë, gjatë kohës së kryerjes së lojës promovionale, atëherë ky klient nuk do të bëhet pjesë e shorteut për atë muaj kur ka mbyllur shërbimin edhe nëse ka përmbushur kriteret e specifikuar në nenin 3.1 për tu kualifikuar në shorte.

#### **NENI 5**

##### **PËRZGJEDHJA E FITUESVE**

5.1 Në këtë lojë promovionale parashikohet të marrin pjesë afërsisht 1750 klientë nga të cilët do të përzgjidhen 18 fitues (3 fitues për çdo muaj kalendarik).

5.2 Shorteu me anën e të cilit të përzgjidhen fituesit për secilin muaj, do të mbahet në ambientet e bankës "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA në adresën: Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, P.O Box 8319, 1001.

5.3 Kompjuteri do të gjenerojë një raport që përmban të gjithë klientët që plotësojnë kriteret e sipërpërmendura ( neni 3 dhe 4). Çdo klient përfaqësohet nga një numër unik identifikimi.

5.4 Përzgjedhja e fituesve do të bëhet në mënyrë rastësore nga një program kompjuterik në prani të një noteri publik të licencuar në RSH, të një përfaqësuesi të autorizuar me shkrim nga Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit pranë Ministrisë së Financave, një përfaqësuesi

te autorizuar me shkrim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, si dhe përfaqësues të tjerë nga stafi drejtues i Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

5.5 Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit pranë Ministrisë së Financave si dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë do të njoftohen me shkrim paraprakisht 20 ditë përpara për datën, orën dhe vendin kur do të zhvillohet shorteu dhe do te ndahen cmimet sipas specifikimeve te Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 196 datë 15.03.2017 "Për përcaktimin e mënyrave, të formave, kritereve dhe të rregullave për organizimin e lojërave të fatit promocionale". Në rast se Banka ka kryer njoftimin si më lart, por përfaqësuesi/t e autorizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit pranë Ministrisë së Financave dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, nuk paraqitet/n personalisht në datën, orën dhe vendin ku zhvillohet shorteu, atëherë Banka do të vijojë me zhvillimin e shorteut dhe ndarjen e cmimeve. Megjithatë në këtë rast Banka do të informojë titullar/in/ët e organeve përkatëse për zhvillimin e shorteut dhe ndarjen e cmimeve.

5.6 Data, vendi dhe ora e hedhjes së shortit do të njoftohen paraprakisht edhe në faqen zyrtare të Bankës <https://www.intesasanpaolobank.al/>.

## **NENI 6 ÇMIMET E PROMOCIONIT**

Çdo muaj do të shpërndahen 3 aparate celularë Samsung A70 për tre fitues. Në total përgjate afatit të lojës promocionale, do të shpërndahen 18 aparate celularë (3 telefona në muaj për 6 muaj) me një vlerë totale prej 723 748 Lek (shtatëqind e njëzet e tre mijë, e shtatëqind e dyzet e tetë lek). Vlera e nje aparati celular me TVSH është 40 208 Lek (dyzet mijë e dyqind e tetë lek).

## **NENI 7 PUBLICITETI**

7.1 Komunikimi i lojës promocionale do të bëhet në faqet zyrtare të Bankes në: web <https://www.intesasanpaolobank.al/>; në rrjetet sociale Facebook (<https://web.facebook.com/IntesaSanpaoloBankAlbania>) e Instagram (<https://www.instagram.com/intesasanpaolobankalbania/>) si dhe do afishohet në degët e Bankës.

7.2 Banka, pas publikimit të lojës promocionale në format e mësipërme, merr të mirëqënë që të gjithë pjesëmarrësit në këtë lojë promocionale kanë lexuar dhe pranuar kushtet e kësaj rregulloreje.

## **NENI 8 NJOFTIMI I FITUESVE**

8.1 Pas hedhjes së shorteut, fituesit do të njoftohen në mënyrë telefonike nga ana e Bankës, në numrin e telefonit që kanë deklaruar në Bankë dhe që figuron i ruajtur në sistemet e bankës. Banka përjashtohet nga çdo përgjegjësi nëse Klienti ka ndryshuar numrin e telefonit dhe nuk ka njoftuar bankën zyrtarisht me shkrim për këtë ndryshim. Klienti do te kontaktohet nga ana e Bankës, nëpërmjet numrit +355687573100.

8.2 Shpallja e fituesve, pas hedhjes së shorteut do të bëhet në faqen zyrtare të Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA në rrjetet sociale zyrtare te bankes ne Facebook (<https://web.facebook.com/IntesaSanpaoloBankAlbania>) dhe Instagram (<https://www.instagram.com/intesasanpaolobankalbania/>), nëse fituesit kanë dhënë paraprakisht pëlqimin me shkrimin për këtë fakt.

---

**NENI 9**  
**RUAJTJA E INFORMACIONIT**

Banka, sipas kërkesave të VKM 770 date 15.07.2009 duhet të ruajë, për një periudhë jo më pak se 6 (gjashhtë) vjet nga data e përfundimit të lojës, të gjithë dokumentacionin e përdorur për organizimin e lojës promovionale të fatit, konkretisht, por pa u kufizuar në: mënyrën e zhvillimit të lojës, numrin e pjesëmarrësve, çmimet e shpërndara, emrat dhe adresat e fituesve.

**NENI 10**  
**TE DHENAT E PJESEMARRESVE**

Cdo pjesëmarrës në këtë Lojë Promocionale pranon shprehimisht se Banka mund të përpunojë të dhënat e tyre personale për qëllime të kësaj loje dhe për cdo qëllim tjetër të ligjshëm të Bankës sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar). Të gjitha të dhënat e mësipërme që lidhen me mënyrën e organizimit të Lojës së Fatit Promocionale do të mbahen për një periudhë jo më pak se 6 vjet sipas kërkesave të VKM 770 date 15.07.2009.

**NENI 11**  
**SHPËRNDARJA E ÇMIMEVE**

11.1 Shpërndarja e çmimeve për fituesit do të kryhet çdo muaj brenda 1 jave pas hedhjes së shorteut. Afati maksimal për tërheqjen e çmimeve nga fituesit është 15 Janari 2021. Çmimet do të tërhiqen pranë degës Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA në adresën Rr Ismail Qemali, Nr 27, Tiranë. Për të tërhequr çmimin, fituesi duhet të paraqesë dokumentin identifikues, kartë identiteti ose pasaportë të vlefshme.

11.2 Banka nuk do të jetë përgjegjëse për fituesin i cili nuk ka dokumentet e nevojshme të vlefshme për identifikimin (pasaportë biometrike apo kartë identiteti). Të gjitha procedurat për pajisjen me pasaporta biometrike dhe kartë identiteti të vlefshme do të jenë nën përgjegjësinë e fituesve të çmimit.

11.3 Çmimet nuk janë të konvertueshme në para. Në rast mosparaqitje brenda afatit maksimal të përcaktuar në nenin 11.1 të kësaj rregulloreje, fituesi humbet të drejtën e çmimit.

---